

**RREGULLORE PËR PËRCAKTIMIN E
KODIT TË ETIKËS
NË
UNIVERSITETIN POLIS**

KREU I PARIME BAZË

NENI 1 Hartimi i rregullores

Kjo rregullore u hartua bazuar në nenin 17, pika 1, të ligjit nr. 9741, dt. 21. 05. 2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe në nenin 14, të Statutit dhe nenin 93 i Rregullores së Përgjithshme të U_POLIS.

NENI 2 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të sjelljes në marrëdhëniet mes anëtarëve të Universitetit, i procedurës që do të ndiqet për trajtimin e shkeljeve të këtyre rregullave dhe i masave që mund të merren në këto raste, si dhe i mënyrës së organizimit dhe funksionimit të Këshillit të Etikës.

NENI 3 Parime bazë

1. U_POLIS është një institucion, anëtarët e të cilit kanë formime të ndryshme, mbulojnë role dhe përgjegjësi të larmishme dhe mbajnë lidhje të shumta dhe të ndryshme. Ekzistenca e një komuniteti kërkon, si njohjen dhe respektimin e të drejtave individuale, po ashtu dhe pranimin e detyrave dhe përgjegjësi kundrejt institucionit universitar, nga të gjithë anëtarët dhe bashkësia.

2. U_POLIS u kërkon pedagogëve, personelit administrativ dhe studentëve, si dhe çdo anëtar tjetër të institucionit, përmbushjen e detyrave respektive në lidhje me rolet dhe përgjegjësitë e marra përsipër, si individualisht, ashtu dhe në kuadrin e organeve kolegjiale, të respektojnë, mbrojnë dhe përkrahin vlerat themelore të institucioneve universitare, mes të cilave:

- a) dinjitetin njerëzor;
- b) mospranimin e asnjë lloji diskriminimi të padrejtë dhe vlerësimin si të meritës, ashtu dhe të larmisë së vlerave individuale dhe kulturore;
- c) respektimin e lirisë dhe të drejtave themelore të njeriut;
- d) përgjegjësi dhe njohje e përmbushje të detyrave kundrejt komunitetit;
- e) ndershmëri dhe profesionalitet;
- f) drejtësi, paanësi, bashkëpunim dhe transparencë.

3. Vlerat e përcaktuara në këtë nen kërkojnë standarde sjelljeje të aplikuara:

- a) në përmbajtjen dhe interpretimin e çështjeve etike të përcaktuara në Kreun II dhe III të kësaj rregulloreje;
- b) në përmbajtjen dhe interpretimin e çështjeve të tjera etike, të rëndësishme për veprimtarinë dhe jetën universitare.

KREU II RREGULLA TË SJELLJES

NENI 4

Mospranimi i asnjë diskriminimi të padrejtë

Të gjithë anëtarët e universitetit kanë të drejtën të trajtohen me mirëkuptim dhe respekt e konsiderim të barabartë dhe të mos diskriminohen, direkt apo indirekt, për shkak të një apo më shumë faktorëve, duke përfshirë fenë, gjininë, orientimin seksual, ndërgjegjen dhe bindjet personale, aspektin fizik dhe ngjyrën, gjuhën, origjinën etnike apo shoqërore, nënshitetësinë, kushtet personale dhe të shëndetit, shtatzaninë, zgjedhjet familjare, moshën etj. Përbën diskriminim të drejtpërdrejtë kur, në bazë të cilitdo prej motiveve të përcaktuara në paragrafin e parë, një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme nga sa është trajtuar apo do trajtohej një tjetër në një situatë të ngjashme.

Përbën diskriminim jo të drejtpërdrejtë, kur një dispozitë, kriter ose praktikë, në dukje të paanshme, mund të vënë në një pozitë jo të favorshme kategoritë e personave të dallueshëm për shkak të faktorëve të renditur në paragrafin e parë, me përjashtim të rastit kur kjo është objektivisht e justifikuar nga një qëllim i ligjshëm.

UPOLIS kundërshton çdo formë të paragjyqimit të padrejtë shoqëror, çdo ngacmim apo shqetësim ardhur për shkak të cilitdo prej motiveve të renditura në paragrafin e parë, çdo praktikë fyese apo poshtëruese, ose idenë e supremacies apo superioritetit moral të një grupi kundrejt një tjetri. Është detyrë e universitetit dhe anëtarëve të tij të inkurajojë iniciativat e drejtuara në mbrojtjen dhe vlerësimin e kategorive të pafavorizuara, ndryshimin individual dhe kulturor.

NENI 5

Abuzime dhe ngacmime seksuale

U_POLIS nuk toleron abuzime apo ngacmime të natyrës seksuale, të kuptuara këto si sjellje diskriminuese që lëndojnë sensin personal të dinjitetit njerëzor dhe u siguron viktimave mbrojtjen e duhur, të lirë nga paragjykimi. Abuzimi dhe ngacmimi seksual përkufizohet si kërkesa për favore seksuale, dhe/ose propozime të padëshirueshme të shërbimeve me përmbajtje seksuale, dhe/ose sjellje apo shprehje verbale fyese që kanë për objekt sferën personale të seksualitetit, drejtuar një personi, duke u nisur nga gjinia apo orientimi i tij seksual. Ekzistenca e një pozicioni jo të barabartë ndërmjet atij që ngacmon dhe viktimës përbën element rëndues të abuzimit apo ngacmimit seksual, për sa mund të verifikohet se:

- a) pranimit nga ana e viktimës është një kusht për pranimin, punësimin apo emërimin në universitet;
- b) pranimit ose refuzimit përbëjnë element të vlerësimit që ka rëndësi për punësimin, emërimin, ngjytjen në karrierë apo të tjera vendime që kanë të bëjnë me viktimën;

NENI 6

Liria akademike

U_POLIS merr përsipër krijimin e një mjedisi që favorizon idealin e lirisë dhe autonomisë individuale, e kuptuar kjo si nevojë e hamendësuar për përparimin, mësimdhënien, profesionalitetin, kërkimin më të gjerë dhe ndjekjen e dijes. Në ushtrimin e lirisë akademike, anëtarët e universitetit duhet të mbajnë një qëndrim të ndershëm dhe të përgjegjshëm, për t'i dhënë komunitetit shkencor dhe shoqërisë metodologjinë, rezultatet, përplotësimin dhe ndikimin etik të kërkimeve.

Anëtarët e universitetit duhet të mbajnë, gjithashtu, një qëndrim bashkëpunimi dhe respekti kundrejt vendimeve akademike të karakterit organizativ, të nxjerra për të qënë në shërbim të efikasitetit, barazisë, paanësisë dhe transparencës së administrimit universitar.

NENI 7

Prona intelektuale dhe plagjiatura

Anëtarët e komunitetit universitar duhet të respektojnë normat që kanë të bëjnë me pronën intelektuale dhe plagjiaturën. Plagjiatura përkufizohet si atribuem i plotë ose i pjesëshëm i fjalëve, ideve, kërkimeve apo zbulimeve të tjetrit, vetes apo një tjetër autori, duke nisur nga gjuha, në të cilën këto janë paraqitur apo shpërndarë zyrtarisht, apo në mungesën e citimit të burimeve. Plagjiatura mund të jetë e qëllimshme ose efekt i një qëndrimi jo të duhur.

NENI 8

Konflikti i interesit

Ka konflikt interesi kur interesi privat i një anëtari të universitetit, me përjashtim të studentit, bie në kundërshtim realisht apo potencialisht me interesin, jo vetëm ekonomik, të universitetit. Anëtari i universitetit, që në një veprim apo rrethanë të caktuar ka interes në konflikt me ato të universitetit, duhet të njoftojë menjëherë organin ose personin përgjegjës apo hierarikisht superior dhe, gjithashtu, duhet të përmbahet nga shqyrtime apo vendime të mundshme, që kanë të bëjnë me të.

NENI 9

Nepotizmi dhe favorizimi

U_POLIS dënon nepotizmin dhe favorizimin, të cilët bien në kundërshtim me dinjitetin njerëzor, me vlerësimin e meritave individuale, profesionalitetin dhe lirinë akademike, me drejtësinë, paanësinë dhe transparencën, dhe u kërkon pedagogëve dhe çdo anëtari tjetër të universitetit të përmbahet nga të tilla zakone dhe t'i referojë Këshillit të Etikës rastet e sjelljeve të dyshimta.

Kemi të bëjmë me nepotizëm apo favorizëm, kur një pedagog apo një pjesëtar i personelit administrativ, direkt ose indirekt, përdor autoritetin e tij apo aftësinë bindëse për të dhënë përfitime, për të favorizuar detyra apo emërimet, për të ndikuar mbi përfundimet e konkurseve apo në procedurat e përzgjedhjes që kanë të bëjnë, në veçanti, por jo ekskluzivisht, me fazën fillestare të formimit në karrierën universitare apo në dhënien përparësi të fëmijëve, familjarëve apo personave që bashkëjetojnë me ta.

NENI 10

Abuzimi me pozicionin

Asnjë anëtari të universitetit nuk i lejohet të përdorë, direkt apo indirekt, autoritetin e pozicionit të vet akademik apo të zyrës së tij me qëllim për të detyruar të tjerë anëtarë të universitetit të kryejnë shërbime avantazhuese për të parët, gjithmonë nëse kjo nuk është parashikuar si një detyrim juridik i të dytëve.

NENI 11

Përdorimi i burimeve të universitetit

Anëtarët e universitetit duhet të përdorin burimet në mënyrë të përgjegjshme dhe të duhur, në mënyrë që të mund të justifikojnë shpenzimet dhe të japin dokumentacionin e duhur apo llogari, me kërkesën e universitetit. Asnjë anëtari nuk i lejohet të përdorë apo t'u lejojë personave apo enteve të jashtme pajisje të kërkimit, hapësira apo burime njerëzore, materiale ose financiare të universitetit, për qëllime të natyrës personale dhe/ose për qëllime të ndryshme nga ato të institucionit universitar, apo në çdo rast jo shprehimisht të miratuara nga ky i fundit.

NENI 12

Përdorimi i emrit dhe i reputacionit të universitetit

Të gjithë anëtarët e universitetit duhet të respektojnë emrin e mirë dhe jo t'i sjellin dëm reputacionit të universitetit. Me përjashtimin kur ka autorizim të shprehur, asnjë anëtar i të universitetit nuk lejohet:

- a) të përdorë në mënyrë jo të duhur logon dhe emrin e universitetit;
- b) të përdorë reputacionin e universitetit në lidhje me veprimtari profesionale, punësime, detyra, apo të tjera veprimtari të jashtme, edhe jo të paguara;
- c) të shprehë pikëpamje ngushtësisht personale duke përdorur emrin e universitetit.

NENI 13

Dhurata dhe përfitime

Anëtarët e universitetit duhet të mos kërkojnë dhe të refuzojnë çdo ofertë jo simbolike të dhuratave apo përfitimeve, të tilla që të ndikojnë, edhe indirekt, zhvillimin e veprimtarive universitare. Anëtarët mund të pranojnë ofertat spontane të dhuratave apo përfitimeve me vlerë ekonomike simbolike në takime kulturore, vizita apo mbledhje (takime) shkencore publike, dhe gjithmonë nëse pranimi i tyre nuk ndikon, as indirekt, në zhvillimin e veprimtarive universitare.

NENI 14

Respektimi i vendimeve

Është detyrim i të gjithë anëtarëve të universitetit të respektojnë të gjitha vendimet që merren nga autoritetet dhe organet drejtuese të institucionit.

NENI 15

Është detyrim i të gjithë anëtarëve të komunitetit universitar veshja dhe paraqitja korrekte dhe estetike.

NENI 16

Në mjediset e universitetit ndalohet përdorimi i pijeve alkolike, substancave narkotike dhe duhanit.

NENI 17

Janë të ndaluara rreptësisht deklaratimet, shkrimet apo publikimet e çdo lloji, që dëmtojnë apo denigrojnë imazhin e universitetit apo të personelit të tij.

NENI 18

Anëtarët e universitetit janë të detyruar të respektojnë të drejtat e individit për privatësi dhe të trajtojnë në konfidencë të gjithë informacionin që u përket atyre mbi këtë bazë.

NENI 19

Përbëjnë shkelje të rëndë të Rregullores së Etikës ndërhyrja në të dhëna jo vetëm personale, marrja e përdorimi i paautorizuar dhe falsifikimi i tyre.

NENI 20

Është detyrim i të gjithë anëtarëve të Universitetit të përmbahen nga sjellje, të tilla që mund të përbëjnë fyerje, shpifje, vërejtje përçmuese apo të papërshtatshme ose sjellje të tjera të ngjashme që janë në kundërshtim me normat etiko-morale të shoqërisë dhe të papranueshme në një institucion universitar.

Dispozita plotësuese

NENI 21

Këshilli i Etikës

1. Këshilli i Etikës pranë Universitetit POLIS është një organ kolegjal i cili diskuton probleme të etikës së jetës universitare. Ai bën propozime Rektorit për këto çështje. Këshilli përbëhet nga 5 pesë antëare nga stafi akademik, nga të cilët një kryetar dhe një sekretar. Këshilli funksionon në mënyrë kolegiale me shumicë të thjeshtë.
2. Anëtarët e Këshillit të Etikës përzgjidhen nga Senati Akademik. Ai përbëhet nga:
 - a) Kryetari (i emëruar nga Rekorati)
 - b) Administratori i Universitetit
 - c) Një specialist i etikës
 - d) Tre përfaqësues të stafit akademik të Universitetit
3. Ky organ ka për qëllim:
 - a) të shqyrtojë dhe t'i propozojë Rektorit parimet etike bazë të veprimtarisë së përgjithshme të Universitetit në funksion të mbrojtjes dhe të sigurimit të të drejtave themelore të njeriut;
 - b) të shqyrtojë dhe të japë mendim për trajtimin e rasteve të veçanta ose problematike që mund të lindin në veprimtarinë e Universitetit;
 - c) të sugjerojë zhvillimin e veprimtarive etike dhe kulturore në funksion të kultivimit dhe zhvillimit të vlerave etike dhe humane
4. Këshilli i Etikës:
 - a) ka funksione këshilluese, të kërkimit, hetimit dhe kontrollit për zbatimin dhe respektimin e normave të kësaj rregulloreje;
 - b) favorizon, ku është e mundur, zgjidhjen me mirëkuptim të mosmarrëveshjeve të mundshme;
 - c) mund t'i propozojë Rektorit veprimin disiplinor kundrejt shkelësve të dispozitave të kësaj rregulloreje.

NENI 22

Respektimi dhe shkelja e Rregullores së Etikës

Në përputhje me sa është përcaktuar në Dispozitat e përgjithshme dhe në Rregullat e sjelljes është, gjithashtu, detyrë e pedagogëve, personelit administrativ, studentëve dhe e çdo anëtar tjetër të universitetit:

- a) të njihet me përmbajtjen e kësaj rregulloreje;
- b) të familjarizohet me standartin e sjelljeve të përfshira në këtë rregullore;
- c) t'i drejtohet Këshillit të Etikës për të marrë këshilla rreth zbatimit të kësaj rregulloreje apo të sjelljes së duhur në lidhje me rastet që parashikohen nga kjo rregullore;
- d) të respektojë këtë rregullore, edhe duke i sinjalizuar menjëherë Këshillit të Etikës sjelljet me shfaqje të dyshimtë.

Shkelja e vërtetuar e kësaj rregulloreje mund të përbëjë motiv për dhënien e masave ndëshkuese.

NENI 23

Procedura për trajtimin e shkeljeve

1. Në rast shkeljesh të Rregullores së Etikës, për rastet që parashikohen shprehimisht në të apo të tjera që përbëjnë, gjithsesi, në shkelje të normave etikomorale të shoqërisë, Këshilli i Etikës vë në dispozicion anëtarë të tij për të hetuar, ndërmjetësuar dhe nëse është e nevojshme, për të ngritur një Grup Dëgjimor.

2. Këshilli mund të vihet në lëvizje kryesisht ose mbi bazën e një ankese. Ai mban një regjistër, në të cilin shënon të gjitha rastet e shkeljeve që trajton. Mënyra e trajtimit të shkeljeve do të jetë përgjithësisht progresive, bazuar mbi natyrën e shkeljes, të rrethanave dhe fakteve që dalin gjatë shqyrtimit.

3. Kur Këshilli i Etikës merr njoftim për një shkelje të Rregullores së Etikës, Rektori cakton një nga anëtarët të ndërmarrë rolin e ndërmjetësuesit dhe/apo të nxjerrë në dritë faktet. Anëtar i caktuar fillon punën duke kontrolluar si fillim nëse personi (anëtar i personelit

apo student) i akuzuar ka apo jo shkelje të regjistruara në regjistrat e këshillit. Në rast se nuk ka shkelje të mëparshme të regjistruara, ai kontakton palët e përfshira në çështje, me shpresën për të gjetur arsye për ndërmjetësim dhe kur nga rrethanat del se faji nuk është tepër i rëndë, mund të tentojë për një zgjidhje me mirëkuptim midis palëve, që nuk do kërkonte përfshirjen e një Grupi Dëgjimor. Po qe se nuk arrihet një zgjidhje me mirëkuptim, kërkohet séance dëgjimore dhe anëtari i caktuar vazhdon të mbledhë fakte nga të gjitha palët e përfshira. Në rastin kur personi i akuzuar ka shkelje të regjistruara, kërkohet një seancë dëgjimore dhe anëtari i caktuar nis kërkimin për mbledhjen e fakteve, me synim përgatitjen e çështjes për dëgjim, në përfundim të të cilit bën një përmbledhje me shkrim, që ia dërgon Rektorit. Rektori kontakton dhe anëtarët e tjerë të këshillit me synimin e thirrjes së një Grupi Dëgjimor. Sekretari mban protokollin e seancës. Vendimi i këshillit merret me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe duhet të bazohet mbi fakte të qarta dhe bindëse.

4.Pasi ka dëgjuar mendimin e secilit prej anëtarëve votues, Rektori vendos për masën ndëshkuese. Vendimi duhet të përmbajë një përmbledhje të fakteve dhe rrethanave të çështjes, rezultatit e votimit, masën ndëshkuese dhe të firmoset nga të gjithë anëtarët që morën pjesë në votim. Në të duhet të pasqyrohet edhe mendimi kundër.

5.Në rastin kur Rektori, pasi ka dëgjuar dhe mendimin e anëtarëve të Këshillit, vlerëson se provat nuk janë bindëse ose janë të pamjaftueshme, ai mund të ngrejë një Grup Dëgjimor në përputhje me specifikat e problemit, i cili pasi shqyrton rastin, rezultatit ia përcjell Rektorit. Rektori e paraqet më tej në Këshillin e Etikës për shqyrtim e votim dhe më pas merr vendim përfundimisht. Vendimi i Rektorit është përfundimtar dhe i formës së prerë.

6.Caktimi i masave ndëshkuese, si rregull do të ketë karakter progresiv, përveç rasteve kur shkeljet janë të rënda. Ai do të bëhet në bazë të llojit të shkeljes, intensitetit, përsëritshmërisë dhe pasojave të ardhura.

NENI 24

Masat ndëshkuese

Në rastet kur vërtetohet shkeljen e dispozitave të kësaj rregulloreje apo rastet e tjera që nuk janë të parashikuara shprehimisht në të, por që përbëjnë sjellje që bien në kundërshtim me normat etiko-morale të shoqërisë, Këshilli i Etikës mund t'i propozojë Rektorit dhënien e masave ndëshkuese si vijon:

Për personelin e institucionit:

- a) vërejtje me shkrim;
- b) paralajmërim për pushim nga puna;
- c) largim nga puna.

Për studentët:

- a) vërejtje me shkrim;
- b) përjashtim nga shkolla për një vit;
- c) përjashtim nga universiteti (heqje e së drejtës së studimit të fituar);
- d) përjashtim përgjithmonë nga universiteti.

NENI 25

Shpërndarja dhe zbatimi i Rregullores së Etikës

Është detyrë e organeve drejtuese të universitetit dhe të fakulteteve të bëjnë shpërndarjen sa më të gjerë të kësaj rregulloreje, nëpërmjet njoftimeve, takimeve, veprimtarive didaktike dhe çdo mënyre tjetër që konsiderohet e duhur për këtë qëllim. Universiteti ndërhyr menjëherë, me çdo mjet për zbatimin e kësaj rregulloreje, në rastet kur kjo gjë bëhet e nevojshme.

Procedura e Kontrollit anti-plagjarizëm e disertacioneve

1. Mbi punën kërkimore të studentit të programit të ciklit të tretë (Doktoraturë) jepen komente te vazhdueshme jo vetëm nga Udhëheqësi dhe bashkë-udhëheqësi por dhe nga Bordi i përbashkët akademik i programit. Këto komente dhe sugjerime reflektohen në temën e kërkimit para se studenti ta nisë atë tek lexuesit e jashtëm sipas parashikimeve të Nenit 8 të marrëveshjes së konsorciumit.
2. Lexuesit e jashtëm përpunojnë një raport ku specifikohet nëse studenti është i gatshëm për të diskutuar apo nëse tema duhet të përpunohet edhe për gjashtë muaj të tjerë.
3. Kur studentit vlerësohet si i gatshëm për të diskutuar, pesë dite pasi janë marrë komentet nga lexuesit e jashtëm dhe janë reflektuar në dizertacion, ky i fundit i nënshtrohet një skanimit me një software specific (Ithenticate) me qëllim identifikimin e origjinalitetit të punës së doktorantit dhe ngjashmërive me material nga burime të tjera. Në përfundim të këtij procesi, gjenerohet raporti i ngjashmërisë i cili i trasmetohet Komisionit ad hoc për kontrollin e origjinalitetit dhe shmangies së plagjiaturës.
 - a. Komisioni, në rast të gjetjes nga skanimi të dizertacionit si punë origjinale dhe pa plagjiaturë, vendos që dizertacioni aprovohet me qëllim dorëzimit në komisionin përfundimtar të mbrojtjes.
 - b. Komisioni vendos që si rezultat i hasjes së problematikave jo-thelbësore me rregullat e shkrimit akademik, të japë rekomandime për modifikime të cilat duhet të përmbushen brenda një afati kohor prej 10 (dhjete) ditësh para dorëzimit tek komisioni përfundimtar i mbrojtjes.
 - c. Komisioni vendos që si rezultat i hasjes së problematikave serioze me rregullat e shkrimit akademik të shtyjë afatin e dorëzimit të doktoraturës me 6 muaj me qëllim rishikimin e problemeve me plagjiaturën
 - d. Komisioni vendos që si rezultat i hasjes së problematikave të mëdha, pra konstatimit të plagjiaturizimit të pezullojë studentin dhe të dërgojë në kwshillin e etikës.
 - e. Në çdo rast, për pikat b,c,d këshilli i profesorëve duhet të organizojë një takim të vecantë me doktorantin për të shpjeguar motivimin e vendimit.
4. Pas rishikimit të dizertacionit konform rregullave të shkrimit akademik, tema i dërgohet më tej Komisionit për Vlerësimin Përfundimtar.